



UNMIK



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT
INSTITUCIONET E PËRKOHSHME TË VETEQEVERISJES
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVJANJA

MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT
MINISTARSTVO ZA KULTURU, OMLADINU, SPORT
MINISTRY OF CULTURE, YOUTH, SPORTS

Departamenti i Kulturës
Departman za Kultururu

Sektori i Bibliotekave

R R E G U L L O R E


PËR

REVIZION DHE Ç'REGJISTRIMIN E KOLEKSIONEVE

TË BIBLIOTEKËS

P R I S H T I N Ë

11.06.2004



Në bazë të nenit 32 alineja 7(shtatë)i Ligjit për bibliotekat në Kosovë,
Ministri i Kulturës, Rinisë, Sportit dhe Çështjeve Jo Rezidente nxjerr këtë:

Rregullore

për Revizion dhe Ç'regjistrimin e koleksioneve të bibliotekës

Neni 1.

Me këtë rregullore përcaktohet mënyra e punës dhe caktohet koha e revizionit dhe çregjistrimit të koleksioneve të bibliotekës.

Të koleksionet e bibliotekës të cilat trajtohen si koleksione të vjetra dhe të rralla,dorshkrimet etj. të cilat kanë rëndësi dhe vlerë të posaçme kulturore,përdoren rregullat e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore,nga se këto koleksione mund të shfrytëzohen vetëm në rregullore të posaçme.

Rregullat mbi përdorimin e koleksioneve të posaçme, bibliotekat i përgadisin me aktet e tyre normative

Neni 2.

Bibliotekat janë të obliguara të bëjnë revizionin e koleksioneve të bibliotekës në bazë të numërit të librave që posedojnë:

- Biblioteka që posedon koleksione librash me mbi **5000** ekzemplarë, duhet të bëjnë revizionin për çdo **2 vjet**.
- Biblioteka që ka koleksione librash deri në **10.000** eksemplar duhet të bëjnë revizionin për çdo **4 vjet**.
- Biblioteka që posedon koleksione librash deri në **50.000** ekzemplarë duhet të bëjnë revizionin për çdo **6 vjet**.
- Biblioteka që posedon koleksione librash deri në **100.000** ekzemplarë duhet të bëjnë revizionin për çdo **8 vjet**.
- Biblioteka që ka koleksione librash deri në **250.000** ekzemplarë duhet të bëjnë revizionin për çdo **10 vjet**.
- Biblioteka që posedon koleksione librash deri në **500.000** ekzemplarë duhet të bëjnë revizionin për çdo **12 vjet!**

- Biblioteka që posedon koleksione librare deri në **500.000** eksemplarë, duhet bërë revizionin në mënyrë kontinueive që mund të zgjatë **20 vjet**.

Neni 3.

Revizioni i koleksioneve të bibliotekës, përveç kur nuk parashihet ndryshe me ndonjë pikë të Rregullores, duhet të bëhet edhe në rastet kur bartet biblioteka në ndonjë lokal tjetër të ri, në rast djegjes nga zjarri, dendimi nga uji, nga tërmeti, vjedhja, shkatërrimi nga lufta dhe kur bëhet ndërrimi i udhëheqësit të bibliotekës.

Neni 4.

Biblioteka është e obliguar të njoftojë përdoruesit më herët mbi kohën e fillimit të revizionit dhe t'iu caktohet afati i kthimit të librave të huazuara të cilat me kohë nuk i janë kthyer bibliotekës. Punën me përdorues, biblioteka duhet ti kordinoi në atë mënyrë që t'iu mundësojë atyre kthimin e librave dhe ti udhëzojë që të shkojnë në biblioteka tjera janë duke punuar me përdorues.

Neni 5.

Vendimin mbi revizionin e koleksioneve të bibliotekës e merr drejtori i bibliotekës së pavarur, ose udhëheqësi i bibliotekës degë.

Vendimin definitiv e merr Këshilli i bibliotekës me propozim të drejtorit të degës, drejtorit të bibliotekës së pavarur, e cila ka më së paku **5 punonjës**.

Detyrat dhe obligimet caktohen me akte normative për:

- përgaditjen e koleksioneve të bibliotekës dhe dokumentacionit të nevojshëm;
- mënyrën e punës gjatë revizionit;
- konstatimin e gjendjes reale të koleksioneve të bibliotekës;
- vlerën e saj materiale dhe;
- vlersimin e pasojave dhe dëmeve.

Me të njejtin akt caktohet edhe afati i fillimit dhe mbarimit të punës në revizion.

Grupi punues (Komisioni) për revizionin e koleksioneve të bibliotekës, pas përfundimit të punës paraqet raport me shkrim, propozimin për çregjistrimin e koleksioneve (me list të posaqme) dhe për mënyrën e çregjistrimit të librave, drejtorit të bibliotekës së pavarur, gjegjësisht drejtorit të bibliotekës degë.

Drejtori i bibliotekës degë duhet ti jepë raport me shkrim drejtorit të bibliotekës ndërkomunale për punën në revizion dhe mënyrën e çregjistrimit të koleksioneve të bibliotekës.

Neni 6.

Biblioteka duhet të bëjë çregjistrimin e librave edhe para afatit të paraparë për revizion, sipas nevojës duke ndar libra të vjetruara, e dëmtuara apo që nuk përdoren fare brenda vitit e më së largu brenda periudhës prej tri vjetësh.

Çregjistrimin e librave e bënë Komisioni, Grupi punues i caktuar sipas **nenit 5 alineja 2** e kësaj Rregulloreje.

Neni 7.

Shuma e librave të çregjistruara gjatë një viti do të sillet varësisht nga numëri i përgjithshëm i koleksioneve të librave në këtë përqindje :

- Deri në **2%** për libra të dëmtuara brenda një viti .,
- Deri në **1 %** për libra të shkatërruara brenda një viti
- Deri në **2%** për libra të vjetruara brenda një viti

Ndërsa për koleksione jo librare, përqindja brenda një viti do të jetë:

- Deri **30 %** për lojëra të ndryshme,
- Deri në **10 %** për kompakt-disqe,
- **10 –20 %** për koleksione audio-vizuele,

Përqindja mund të jetë më e madhe në raste nga neni **3 alineja 1** e kësaj rregulloreje.

Të gjitha librat e çregjistruara shënohen në librin e inventarit në vendin e caktuar të katalogut elektronik. Koleksionet e çregjistruara shënohen në fushën e vërejtjes, e “çregjistruar” dhe data e çregjistrimit.

Neni 8.

Të gjitha librat e çregjistruara shenohen në regjistër të posaçëm, vulosen me vule të posaçme, e cila duhet të përmban këto të dhëna:

- në pjesën e epërme të vulës , emri i bibliotekës;
- në pjesën e poshtme, në anën e majtë **E Ç'REGJISTRUAR** , ndërsa pjesa e djathtë poshtë, duhet të jetë e zbrazët për të shënuar datën e çregjistrimit, revizionit, nr. i vendimit për revizion dhe çregjistrim.
- dimensionimi i vulës duhet të jetë **5x2.5 cm**. Vula epet pas shenjës së vulës së numrit të inventarit.

Neni 9.

Bibliotekat janë të obliguara t'iu ofrojnë bibliotekave koleksionet e çregjistruara sipas nenit 10 dhe 11!

Neni 10

Biblioteka kombëtare dhe Universitare e Kosovës është e obliguar të formojë katalogun alfabetik të koleksioneve të çregjistruara nga të gjitha bibliotekat në Kosovë. Koleksionet e çregjistruara, bibliotekat nuk guxojnë t'ia ofrojnë asnjë biblioteke , derisa BKUK të bënë zgjedhjen e koleksioneve që ka nevojë. Bkuk është e obliguar që brenda 14 dite të njoftojë bibliotekën për zgjedhjen e librave që ka nevojë.

Neni 11

Librat e çregjistruara, bibliotekat janë të obliguara të t'iu ofrojnë bibliotekave sipas radhës:

- Bibliotekat publike iu ofrojnë librat bibliotekave ndërkomunale;
- Bibliotekat e fakulteteve iu ofrojnë libra , bibliotekës universitare dhe pastaj bibliotekave tjera të fakulteteve dhe bibliotekave të veçanta ;
- Bibliotekat e shkollave, bibliotekave tjera shkollore në mesin e tyre, apo në komunën fqinj, ndërsa koleksionet e vendlindjes, bibliotekës ndërkomunale;
- Bibliotekat speciale iu ofrojnë libra bibliotekave universitare dhe pastaj bibliotekave tjera të veçanta.

Neni 12

Në rastet kur Biblioteka Kombëtare dhe bibliotekat ndërkomunale nuk janë të interesuara për librat e ofruara nga ndonjë bibliotekë ndërkomunale dhe komunale, atëherë bibliotekat të cilave u ofrohet lista e librave të çregjistruara, janë të obliguara t'i japin përgjigje me shkrim ofruesit në afat prej 14 ditësh!

Koleksionet e librave që janë për çregjistrim, për të cilat nuk ndihet nevoja e bibliotekave të lartpërmendura, ato koleksione mund të dërgohen në përpunim të letrës ose të vendosen në një vend të posaçëm, që më vonë ti dërgohen fabrikës për përpunimin e letrës.

Neni 13.

Çdo bibliotekë pas revizionit, është e obliguar që të kompletoj listat nga revizioni, spastrimi, gjegjisht çregjistrimi i koleksioneve librare dhe jo librare dhe të ruajë mirë në bibliotekë sipas rregullave për ruajtjen e dokumentacionit në regjistrator.

Neni 14.

Kjo Rregullore hyn në fuqi pas nënshkrimit nga ministri

Ministri i Kulturës, Rinisë, Sporteve dhe ÇJR

Mr. Behxhet Brajshori.

